



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1260/11 Prot.

Tiranë, më 27 / 10 / 2020

V E N D I M

Nr. 21 datë 27. 10. 2020

P Ë R

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SIGURIMIN E AMBIENTEVE SHITESË TË
NEVOJSHME, NË FUNKSION TË VEPRIMTARISË SË FAKULTETIT TË
INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, SI DHE FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE
URBANISITIKËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UPT-së, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 195/1 prot, datë 28.09.2020 të FIN, shkresën nr. 262/2 prot, datë 20.10.2020 të FAU, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 153/2 prot, datë 23.10.2020, Bordi i Administrimit i UPT-së,

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Administratorin e Institucionit të fillojë procedurat për studimin e tregut për të siguruar ambientet shtesë të nevojshme për zgjidhjen afatshkurtër të nevojave infrastrukturore, në funksion të veprimitarisë së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU).
2. Studimi i tregut për ambientet shtesë të nevojshme, të përqëndrohet në godinat publike dhe/ose private, duke synuar zgjidhjen më të mirë ekonomike dhe funksionale.
3. Administratori i Institucionit të bashkëpunojë me autoritetet drejtuese akademike dhe administrative të FIN dhe FAU, për realizimin e këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

Arben DHIMA

